



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Pogradec, me 24.02.2026

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROKURIMIT: **Përfundim i punimeve në objektin “Rehabilitim Kopshti “Liri Çomo”, Pogradec”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punë ndërtimore-45000000-0 ;

Punë ndërtimi-45232411-6;

VLERA E FONDIT LIMIT: **14 665 964, 12 (katërmëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër presje dymbëdhjetë) lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, autoriteti / enti kontraktor Bashkia Pogradec, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- Formulari i ofertes sipas Shtojcë 1;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

*Kerkesat e mesiperme jane detyruese dhe i sherbejne Autoritetit Kontraktor per te krijuar bindjen e tij se operatoret ekonomik pjesemarres ushtrojne veprimtarine e tyre konform kerkesave te legjislacionit ne fuqi, permbushin kriteret ligjore per te marre pjese ne procedura prokurimi si dhe kane shlyer te gjitha detyrimet tatimore dhe ato te energjiise elektrike sipas percaktimeve te legjislacionit perkates.*

*Po ashtu, paraqitja e sigurimit te ofertes eshte detyrim ligjor i percaktuar nga legjislacioni ne fuqi mesipercituar, si nje mjet garancie per AK ne rast te tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave; refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit apo mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimi të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.*

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, Nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike për realizimin e objektit të prokurimit dhe marrjen persiper të çdo rreziku, që mund të ndodhë, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës në procedurën e prokurimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, i ndryshuar, si dhe nenet 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj dhe është në përpjesëtim të drejtë me fondin limit të procedurës. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 64 Deklarata Tatimore; Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të

tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Gjithashtu bazuar në nenin 43 paragrafin 1 dhe në pikën b) të paragrafit 2 të këtij neni në VKM-ë nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku thuhet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”

“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së i ndryshuar, të nenit 43, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Gjithashtu bazuar në pikën 4, të nenit 43, të VKM-ë nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku thuhet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit<sup>45</sup>. Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.”

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 pranë njërive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

*Shenim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nepermjet plotesimit dhe paraqitjes nga OE të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të par, pranë Autoritetit Kontraktor, përparapublikimit të njoftimit të fituesit dhe nënjes së afatëve të ankimit, ose nëse do të jete nevoja për t'u kerkuar sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi.** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, nën 3.1/a, b, c dhe nën 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar.

Megjithatë operatorët ekonomikë kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për Vitin 2025, në të gjitha vendet atje ku ushtrojnë aktivitetin e tyre, sipas ekstraktit të QKB.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë **jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës** që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është **jo më e vogël se** dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet;

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

**Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten :**

1. Formularin e vleresimit sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
2. Kontratë
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudit;

**Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten**

1. Kontrate;
2. Situacionin përfundimtar;
3. Akt kolaudimi;
4. Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: **“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.**

**Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.**

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Lidhur me dokumentacionin e kërkuar për vërtetimin e punëve të ngjashme janë kërkuar keto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku ndër të tjera përcaktohet se: **Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.**

**Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.**

Në kuadër të vlerësimit të ofertave në menyre sa më të drejte, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktimit, vlerësimi i përvojës të mëparshme të vërtetohet me paraqitjen e kontrates së bashkepunimit apo marreveshjes së nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit lëshuar nga Institucioni. Dokumenta keto të nevojshme për të vlerësuar lidhur me punët konkrete që ka kryer OE si anetar i BOE, apo si nënkontraktor. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta

kete çdo kompani në dosjen e saj, per rrjedhoje nuk mund te sjelle kufizim te pjesmarrjes se OE ne tender as ne menyre direkte dhe as ne menyre indirekte.

**Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:**

*Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore të sipërcituar dhe vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.*

*Kriteret e mëposhtme teknike nga pika 2.3.2 dhe ne fund janë propozuar dhe vendosur nga specialisti i fushës, Inxhinieri i Njesise se Prokurimit, pjesë e struktures qe ka hartuar projekt-preventivin, sipas përcaktimit të nenit 74, dhe 78 të VKM nr. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, Njoftimit nr. 4916/2 prot, datë 14.07.2022, pika 1, të Agjencisë së Prokurimit Publik “**Mbi organizmin e Procedurave të Prokurimit Publik**” si dhe Rekomandimit te APP nr. 787 prot, date 23.01.2026, me lende: “Mbi Hartimin e kriterëve per kualifikim per Procedurat e Prokurimit per Mallra, Pune, Sherbime”.*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet te paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

**Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:**

**N.P – 1 A** Punime gjërmimi në tokë

**N.P - 3 A** Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash

**Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë:**

**N.S – 4 A** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.

**N.S- 8 A** Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjise, (ose Ministrise kompetente te kohes) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja ne kete forme eshte kusht skualifikues.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari

ndërtimi". Gjithashtu, të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*" të ndryshuar, Neni 8 përcakton "*Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane*" si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 "*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*", pika 1.1 ku përcaktohet se: *çdo subjekt juridik i licencuar ka të drejtë të ushtrojë veprimtari zbatimi, vetëm në klasat dhe kategoritë e punimeve, që ka përcaktuar në licencë. Kushtet dhe kriteret, që duhet të plotësojë subjekti juridik për të fituar klasa e kategori në zbatimin e punimeve të ndërtimit, përcaktohen në rregulloren për dhënien e licencave profesionale, që miraton Ministri i Rregullimit të Territorit dhe i Turizmit.*

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

#### **NP-1 A                      Punime gjërmimi në tokë**

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, punime gjërmimi në tokë *konsiderohen gjërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.*

Vendosja e kësaj pike license si kriter lidhet me zbatimin e punimeve të parashikuara të realizohen nëpërmjet kësaj procedure. Dokumentacioni teknik i hartuar nga projektuesi parashikon punime gjërmimi, sistemimi të dherave dhe ndryshime të volumit të tokës, si rezultat i rikonstruksionit të shkollës 9 vjecare "Kajo Karafili". Të tilla punime përfshihen në zërat e punimeve të gjërmimit.

Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

Në total vlerat për realizimin e ndërtimit të shtesës anësore dhe strukturave të nevojshme që lidhen me objektin i përcaktojnë të tilla punime në kategorinë A sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008, të ndryshuar.

#### **N.P - 3 A              Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash**

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar punime të tilla *konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.*

Sic është parashikuar edhe në projekt kemi të bëjmë me një ndërtues ekzistues. Për këtë arsye dhe për të plotësuar nevojat e shkollës me klasa dhe me parametra bashkëkohorë është e domosdoshme rikonstruksioni i shkollës. Këto punime janë parashikuar në preventiv si veshje fasade me polisterol kompakt, cati vendi zakonisht HD~8m, mbuluar me tjegulla vendi etj. Për zbatimin e punimeve të tilla është e nevojshme që të anagzhohen subjekte të specializuara, të cilët zotërojnë licensën N.P – 3. Kategoria A i referohet vlerës totale të këtyre punimeve në preventivin e projektit të zbatimit.

#### **N.S - 4 A              Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.**

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar me punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese

*konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.*

Vendosja e këtij kriteri u referohet punimeve të parashikuara në projektet teknikë, relacionet teknikë, specifikimet, preventivin dhe grafikun e punimeve për zbatimin e veprës. Këto punime parqiten të detajuara në projektin arkitekturor dhe specifikimet e punimeve ndërtimore. Punimet e parashikuara në këtë dokumentacion teknik përfshijnë punime murature, punime dyersh dhe dritaresh, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme, punimeve shtresash për izolimin termoakustik dhe punime të ndryshme izolimi. Vëllimi dhe vlerat e punimeve të tilla janë të konsiderueshme. Tipologjia e mureve, veshjeve, rifiniturave, dyerve dhe dritareve në objekt është e larmishme. Për zbatimin e punimeve të tilla, VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar, përcakton se duhet të disponohet licenca NS-4.

Nga sa më sipër, duke marrë në analizë të gjithë dokumentacionin teknik, specifikën e punimeve dhe vlerat e të gjithë punimeve të tilla në preventivin total të kësaj ndërhyrjeje, u vendos si kriter teknik profesional licenca NS-4 B, e cila është e domosdoshme për vlerën, rëndësinë dhe kompleksitetin e punimeve të tilla.

#### **N.S - 8 A Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri**

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar punime të tilla si *montimi në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër. Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë të drejtë të trajtuar përpara.*

Këtu përfshihen punimet për veshje fasade me alukobonde, konstruksione metalike te perbera.

Kategoria A i referohet vlerës së këtyre punimeve në preventivin total dhe përcaktimeve të VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

| Kategoria e kërkuar | Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës | Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse | Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive | Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse |
|---------------------|--------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------|
| N.P-1 A             | Punime gërmimi në tokë                                 | Germim dheu me ekskavator me goma 0.25m3,                                                      | 0-20 mln leke                                             | Nuk e kalon vlerën 20 milion lek.                                                              |

|           |                                                                                                                                                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |               |                                   |
|-----------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------|-----------------------------------|
| N.P-3 A   | Rikonstrukcion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash                                                                             | Prishje catie ekzistuese me tjegulla marseljeze<br>Çati vendi e zakonshme me HD~8m,tjegulla marseljeze<br>Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100<br>Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33cm                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | 0-20 mln leke | Nuk e kalon vlerën 20 milion lek. |
| N.S-4 A   | Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifinitura me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese | Shtrese me pllaka gres porcelanat<br>Veshje me pllake majolike<br>Shtrese me pllaka mermeri<br>Pragje dhe plintuese gres<br>Boje hidroplastike cilesi e larte<br>Boje hidroplastike<br>Boje vaji siperfaqe e patinuar<br>F V dritare d/alumini plastike me dopio xham<br>Heqje i dritareve dhe dyerve ekzistuese<br>F V dyer d/alumini plastike me dopio xham<br>F V dyer te brendehme druri cilesi e I-re.<br>Dyer d/alumini me mbushje element d/a.<br>Shtrese parketi laminat<br>Nenshtresa dhe shtresa ne territorin e ndertesave<br>Gjelberim dhe mbjellje bimesh dekorative | 0-20 mln leke | Nuk e kalon vlerën 20 milion lek. |
| N.S – 8 A | Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri                                                                                    | Shtrese betoni c6/10<br>Plinta betonarme c25/30<br>Kolona betonarme monolite c25/30, h-4m<br>Mur me blloqe betoni per rrethimin e ambienteve te jashtme<br>Kangjella dekorative hekuri me figuracion mesatar<br>Suvatime e zakonshme fasade mur tulle<br>Porte metalike dekorative dhe kapuc granili                                                                                                                                                                                                                                                                              | 0-20 mln leke | Nuk e kalon vlerën 20 milion lek. |

**2.3.3** Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) **Drejtuesin Teknik** të punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të jetë në Listëpagesa për muajin e fundit nga Hapja e Ofertave, i shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtem:

- Kontrate pune e vlefshme (përkatëse)
- Diplomë
- Cv

**Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

**Argumentimi:** Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, i ndryshuar.

Së dyti, vendosja e këtij kriteri mbështetet në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4.1, ku përcaktohet se *drejtimi i kantierit sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga sipërmarrësi ose nga drejtuesit e kantierit (drejtori i punimeve/përgjegjësi teknik i kantierit), që emërohen prej tij. Në rastet kur drejtuesi ligjor e teknik i sipërmarrësit nuk udhëheq drejtpërdrejt punimet në kantier njoftohet, zyrtarisht, investitori për drejtuesit e punimeve dhe personat e tjerë, të emëruar me detyrë në kantier.*

Së treti duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: *“drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi”* si dhe pikës 2.1 ku citohet se *“drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit., gjithashtu jemi në kushtet e parashikuara në pikën 2.1 të Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.*

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: *“Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit”* dhe pika 2: *“elementët e licensës”* gërma “c” ku citohet se: *“Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.*

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

**2.3.4** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet te kete te punesuar staf inxhinierik te perfshire ne licensen e shoqerise, si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi            1 (një)
- Inxhinier Mekanik            1 (një)

Secili prej Inxhinierëve të mësipërm duhet të jenë të siguruar dhe të figurojnë me kohë të plotë, dokumentuar kjo me **vertetimin** e pageses së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga administrata tatimore dhe **listepagesat** e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Për secilin prej pjesëtarëve të stafit duhet të paraqitet:

- kontratë pune e vlefshme
- diplomat përkatëse.

**Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nënjes së afatëve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

**Argumentimi:** Autoriteti Kontraktor këto kritere i ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6.

Keto kritere i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për tu bindur se OE zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Nga AK janë përcaktuar kriteret e nevojshme për personelin e kualifikuar sipas niveleve të ndryshme të kualifikimit dhe profileve të nevojshme mbështetur në tipologjinë e punimeve, si dhe kërkesat për fuqi punëtore referuar përmasave dhe natyrës së kontratës, objekt prokurimi.

Në kërkesat për personelin e kualifikuar nga AK janë kërkuar disa kategori personeli, të domosdoshëm për të kryer të gjitha shërbimet e nevojshme dhe mbulimin e të gjitha hallkave/etapave të zbatimit të projektit, sipas nivelit të kompetencave profesionale deri në realizimin e plotë të veprës.

Në kërkesat për personelin e kualifikuar janë kërkuar inxhinierë të licensuar, sipas profileve të domosdoshme për të mbuluar të gjitha punimet e parashikuara në projekt – zbatimin e parashikuar të relizohet nëpërmjet kësaj kontrate. Një pjesë e këtyre ekspertëve duhet të jenë të përfshirë në licensën e shoqërisë, ndërsa pjesa tjetër jo domosdoshmërisht të përfshirë në licensën e shoqërisë, por me kontratë pune.

- Projekti, objekt i kësaj kontrate parashikon një sasi dhe tipologji të madhe të punimeve të përgjithshme ndërtimore, të tilla si punimet e prishjes, punimet e gërmimit, punimet e shtresave, punimet e muraturës, sistemit e jashtme etj. Punimet ndërtimore përbëjnë pjesën më të madhe të vëllimit të punëve për zbatimin e projektit, sikurse edhe ato më komplekset. Punimet e ndërtimit duhet të përmbushin kushtet teknike të zbatimit. Respektimi i kërkesave për qëndrueshmëri strukturore dhe qëndrueshmëri, plotësimi i kërkesave për mbrojtjen pasive nga zjarri, përdorimi i materialeve që nuk janë të dëmshëm për jetën dhe shëndetin e përdoruesve të ambienteve dhe saktësia në realizimin e të gjithë elementëve konstruktivë sjellin domosdoshmërinë që çdo element dhe hallkë e zbatimit të këtyre punimeve të ndiqet dhe udhëhiqet nga ekspertë të licensuar të fushës.

Inxhinieri i ndërtimit - Zbatimi i punimeve të përgjithshme ndërtimore dhe zbatimi i punimeve strukturore duhet të realizohet me materialet dhe teknologjitë e parashikuara në projektin e zbatimit, metodologjia e ndëkur e zbatimit të këtyre punimeve duhet të përputhet me specifikimet teknike dhe

standardet dhe kriteret e zbatimit nga ekspert inxhinier ndërtimi. Ndjekja e të gjithë procesit ndërtimor që në fazën e pastrimit të sheshit, punimet e ngritjes së kantierit, skelerive, objekteve ndihmëse, punimet e muraturës, punimet e shtresave izoluese, realizimi i daljeve për sistemet teknike të ndërtësës realizimi i strukturës mbajtëse, punimet e përforcimit strukturor, punimet për realizimin e konstruksioneve metalike të thjeshta dhe të përbëra janë punime të parashikuara në projektet e punimeve ndërtimore dhe në preventivin respektiv.

Inxhinieri mekanik – Zbatimi i punimeve për sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit, në zërat e punimeve të paraqitura në preventiv: FV hidrant zjarri, FV fikeze zjarri me pluhur, FV buton sinjalizimi zjarri, FV zbritje shkalle, FV rrezik zjarri nga pajisjet nën tension, FV ndalim i shurjes së zjarrit me ujë, FV Dalje emergjence etj.

**2.3.5** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **22 persona**, dokumentuar kjo me **vertetimin** e pageses së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga administrata tatimore dhe **listepagesat** e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

*Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

**Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

| REHABILITIM I OBJEKTIT EKZISTUES |         |                                                     |        |        |          |               |
|----------------------------------|---------|-----------------------------------------------------|--------|--------|----------|---------------|
| NR.                              | KODI    | EMËRTIMI I PUNIMEVE.                                | NJËSIA | SASIA  | OP/NJESI | OP/TOTAL      |
|                                  |         | <b>1. PRISHJE</b>                                   |        |        |          |               |
|                                  | 2.430/2 | Prishje çatie ekzistuese me tjegulla                | m2     | 367.00 | 1.62     | 594.54        |
|                                  |         | <b>SHUMA 1:</b>                                     |        |        |          | <b>594.54</b> |
|                                  |         | <b>8. PUNIME HIDROIZOLIMI DHE ÇATITE</b>            |        |        |          |               |
| -                                | 2.219   | Çati vendi e zakonshme me HD~8m,tjegulla marseljeze | m2     | 367.00 | 2.30     | 844.10        |

|       |         |                                                              |    |          |      |                 |
|-------|---------|--------------------------------------------------------------|----|----------|------|-----------------|
| -     | 2.209   | Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100           | ml | 40.00    | 1.09 | 43.60           |
| -     | 2.212   | Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33cm          | ml | 80.00    | 1.30 | 104.00          |
|       |         | <b>SHUMA 8:</b>                                              |    |          |      | <b>991.70</b>   |
|       |         | <b>2. PUNIME DYER DRITARE</b>                                |    |          |      |                 |
| 2     | 2.391   | Heqje dyer ekzistuese                                        | m2 | 46.00    | 1.20 | 55.20           |
| 3     | 2.395/a | Dyer d/alumini me mbushje element d/a.                       | m2 | 25.60    | 2.40 | 61.44           |
| 4     | 2.383/1 | F V dyer te brendeshme druri cilesi e l-re.                  | m2 | 33.66    | 0.66 | 22.22           |
| -     | 2.375/1 | F V dritare d/alumini plastike me dopio xham                 | m2 | 79.20    | 2.65 | 209.88          |
| -     | 2.395/1 | F V dyer d/alumini plastike me dopio xham                    | m2 | 40.00    | 2.67 | 106.80          |
| -     | 2.370/1 | Heqje i dritareve dhe dyerve ekzistuese                      | m2 | 79.20    | 0.95 | 75.24           |
|       |         | <b>SHUMA 2:</b>                                              |    |          |      | <b>530.78</b>   |
|       |         | <b>5. PUNIME BOJATISJE</b>                                   |    |          |      |                 |
| 12    | 2.404   | Boje hidroplastike                                           | m2 | 2,215.00 | 0.36 | 797.40          |
| An.12 | 2.403   | BOJE VAJI SIP PATINUAR                                       | m2 | 350.00   | 0.37 | 129.50          |
|       |         | <b>SHUMA 5:</b>                                              |    |          |      | <b>926.90</b>   |
|       |         | <b>6. PUNIME SHITRESASH 2</b>                                |    |          |      |                 |
| -     | 2.326   | Veshje me pllake majolike                                    | m2 | 150.00   | 3.70 | 555.00          |
| An.2  | 2.267/a | Shtrese me pllaka grez porcelanato                           | m2 | 190.00   | 1.66 | 315.40          |
| An.4  | 2.273   | Shtrese pllaka mermeri t = 20 mm                             | m2 | 21.00    | 2.80 | 58.80           |
| An.5  | 2.273   | Shtrese parmaku e pragjesh pllaka mermeri t = 20 mm          | m2 | 16.00    | 2.80 | 44.80           |
| An.7  | 2.324b  | Plintuse gres h=10cm                                         | m2 | 150.00   | 0.35 | 52.50           |
| An.13 | 2.281   | Heqje pllaka dysHEMEJE                                       | m2 | 190.00   | 1.00 | 189.24          |
|       |         | <b>SHUMA 6:</b>                                              |    |          |      | <b>1,215.74</b> |
|       |         | <b>7. NENSHTRESA DHE SHITRESA NE TERRITORIN E NDERTESAVE</b> |    |          |      |                 |
| 15    | 2.276/a | Shtrese parketi laminat                                      | m2 | 414.00   | 3.65 | 1,511.10        |
|       |         | <b>SHUMA 7:</b>                                              |    |          |      | <b>1,511.10</b> |
|       |         | <b>9. PUNIME TE NDRYSHME</b>                                 |    |          |      |                 |
| 17    | 3.62    | Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka                            | m2 | 411.30   | 2.14 | 880.18          |

|       |          |                                                                                                                          |             |        |       |                    |
|-------|----------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|--------|-------|--------------------|
| 18    | 3.643    | Mbjellje bari ne skarpat                                                                                                 | m2          | 350.00 | 0.17  | 59.50              |
| -     | 3.87/a   | Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke | m3          | 101.00 |       | Ekskavator 0.25 m3 |
| An.1  | 2.258    | Nenshtrese zhavori                                                                                                       | m3          | 51.00  | 2.90  | 147.90             |
| An.12 | 3.616    | F V bordura betoni 12x25cm                                                                                               | ml          | 130.00 | 0.75  | 97.50              |
| An.13 | 2.261/a  | Shtrese rere ne teritorin e ndertesave                                                                                   | m3          | 51.00  | 0.87  | 44.37              |
| An.14 | an.      | Stola                                                                                                                    | cope        | 8.00   |       | -                  |
| An.15 | 3.962    | F.V. Fidane shkurre dekorative "Oleander"                                                                                | cope        | 30.00  | 1.00  | 30.00              |
| An.16 | 3.966    | F.V mbjelleje peme dekorative Bli                                                                                        | cope        | 10.00  | 1.00  | 10.00              |
| An.17 | 3.643/c  | Mbushje me Humus t=20 cm                                                                                                 | m2          | 302.00 | 0.08  | 24.16              |
|       |          | <b>SHUMA 9:</b>                                                                                                          |             |        |       | <b>1,293.61</b>    |
|       |          | <b>11.Punime per murin rrethues</b>                                                                                      |             |        |       |                    |
| -     | 3.87/a   | Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke | m3          | 25.00  |       | Ekskavator 0.25 m3 |
| -     | 2.262    | Shtrese betoni C 6/10                                                                                                    | m3          | 2.90   | 8.60  | 24.94              |
| -     | 2.585    | Plinta b/a C25/30                                                                                                        | m3          | 6.70   | 6.93  | 46.43              |
| -     | 2.117/1b | Kollona b/a monolite C 25/30 h ~ 4m                                                                                      | m3          | 4.30   | 31.22 | 134.25             |
| An.19 | 2.88     | Mur me blloqe betoni 20cm, deri - 3m, me LL.P. M-15                                                                      | m3          | 6.40   | 10.00 | 64.00              |
| An.26 | 2.691    | Brez b/a C 12/15                                                                                                         | m3          | 1.40   | 18.76 | 26.26              |
| -     | 2.166    | F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm                                                                                    | ton         | 2.00   | 60.00 | 120.00             |
| An.1  | 2.258    | Nenshtrese zhavori                                                                                                       | m3          | 2.10   | 2.90  | 6.09               |
| An.20 | 2.413    | F.V Kangjella dekorative hekuri me figuracion mesatare                                                                   | ton         | 0.80   | 54.60 | 43.68              |
| An.21 | 2.401    | Boje Vaji per siperfaqe metalik 2 duar                                                                                   | m2          | 26.00  | 1.47  | 38.22              |
| An.22 | 2.331    | Suva e zakonshme fasade mur tulle ~ 8m                                                                                   | m2          | 420.00 | 2.18  | 915.60             |
| -     | 2.404    | Boje hidroplastike                                                                                                       | m2          | 420.00 | 0.36  | 151.20             |
| An.23 | 2.415    | F.V. Porte metalike dekorative rreshqitese                                                                               | m2          | 7.00   | 2.46  | 17.22              |
| An.24 | 2.266/1  | Kapuç granili me boje                                                                                                    | m2          | 12.00  | 1.54  | 18.48              |
|       |          | <b>Shuma 11</b>                                                                                                          | <b>LEKE</b> |        |       | <b>1,606</b>       |
|       |          | <b>12.SHKARKIMI I UJRAVE TE SHIUT</b>                                                                                    |             |        |       |                    |
| -     | 3.87/a   | Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m <sup>3</sup> , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke | m3          | 67.10  |       | Ekskavator 0.25 m3 |
| An.13 | 2.261/a  | Shtrese rere                                                                                                             | m3          | 15.00  | 0.87  | 13.05              |
| -     | 2.523/1  | F.V Tuba PVC f=200 mm te brinjezuar                                                                                      | ml          | 135.00 | 0.24  | 32.67              |

| An.25                | 2.341    | Pusete shiu 40 x 40, h = 100 cm, me kapak zgare hekuri                                                                                                                                                                                                            | cope        | 4.00   | 4.20 | 16.80           |
|----------------------|----------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------|--------|------|-----------------|
|                      |          | <b>Shuma 12</b>                                                                                                                                                                                                                                                   | <b>LEKE</b> |        |      | <b>62.52</b>    |
| <b>Shuma Analiza</b> |          |                                                                                                                                                                                                                                                                   |             |        |      | <b>8,733.26</b> |
| NR.                  | KODI     | EMËRTIMI I PUNIMEVE.                                                                                                                                                                                                                                              | NJËSIA      | SASIA  |      | VLEFTA          |
|                      |          | <b>PUNIMET ELEKTRIKE</b>                                                                                                                                                                                                                                          |             |        |      |                 |
|                      |          | <b>D1. PAISJE ELEKTRIKE</b>                                                                                                                                                                                                                                       |             |        |      |                 |
|                      |          | <b>I. UPS</b>                                                                                                                                                                                                                                                     |             |        |      |                 |
| 2                    | AN-E-205 | F.V UPS, 1-fazor rack mounted<br>- I kompletuar me bateri<br>- Fuqia: 1.5 kw<br>- Tensioni ne hyrje: 400 V<br>- Tensioni ne dalje: 400 V<br>- Frekuenca: 50 Hz<br>- Niveli i zhurmave: < 45 dBA<br>- Temperatura e punës: 0 – 40 °<br>- Autonomia UPS : 15 minuta | cope        | 1.00   | 1.00 | 1.00            |
|                      |          | <b>Shuma</b>                                                                                                                                                                                                                                                      |             |        |      | <b>1.00</b>     |
|                      |          | <b>III.ndricimi I jashtem</b>                                                                                                                                                                                                                                     |             |        |      |                 |
| 10                   | AN-E-206 | F.V Shtylle ndricimi metalike, celiku e zinguar ne te nxehte dhe e lyster me boje elektrostatike H=4,0m, per ndricimin e fushes sportive                                                                                                                          | cope        | 4.00   | 2.00 | 8.00            |
| 11                   | AN-E-207 | F.V Ndricues tip prozhektor, LED 50W, 4000K, IP66 per ndricimin e fushes sportive                                                                                                                                                                                 | cope        | 4.00   | 1.00 | 4.00            |
|                      |          | <b>Shuma</b>                                                                                                                                                                                                                                                      |             |        |      | <b>12.00</b>    |
|                      |          | <b>SHUMA PAISJE ELEKTIRKE</b>                                                                                                                                                                                                                                     |             |        |      | <b>13.00</b>    |
| <b>E.1</b>           |          | <b>SISTEMI I MBROJTJES KUNDER ZJARRIT</b>                                                                                                                                                                                                                         |             |        |      |                 |
| <b>E.1-1</b>         |          | <b>Materiali Instalimi</b>                                                                                                                                                                                                                                        |             |        |      |                 |
| E-1.1                | 2.493/1  | F.V Tubo çeliku i zi pategel Ø 3" x 3.65 mm, me mberthime Victaulic                                                                                                                                                                                               | kg          | 52.80  | 0.76 | 40.18           |
| E-1.2                | 2.493/1  | F.V Tubo çeliku i zi pategel Ø 2½" x 3.25 mm, me mberthime Victaulic                                                                                                                                                                                              | kg          | 352.00 | 0.76 | 267.52          |
| E-1.3                | 2.493/1  | F.V Tubo çeliku i zi pategel Ø 2" x 3.25 mm, me mberthime Victaulic                                                                                                                                                                                               | kg          | 30.80  | 0.76 | 23.41           |
| E-1.4                | 2.493/1  | F.V Tubo çeliku i zi pategel Ø 1½" x 2.90 mm, me mberthime Victaulic                                                                                                                                                                                              | kg          | 30.80  | 0.76 | 23.41           |
| E-1.5                | 2.494/4  | F.V Valvol nderprerese me sferë DN 40 (1½")                                                                                                                                                                                                                       | cope        | 9.00   | 1.20 | 10.80           |
| E-1.6                | Analize  | F.V Rakorderi çeliku i zi (Bryla,Ti, reduksione etj). Mberthimi i rakorderive do te behet me kapje Victaulic                                                                                                                                                      | kg          | 79.20  | 0.76 | 60.19           |
| E-1.7                | Analize  | F.V Mberthime te rakorderive me kapje Victaulic                                                                                                                                                                                                                   | cope        | 20.00  | 0.50 | 10.00           |
| <b>E.1-2</b>         |          | <b>Sinjalistika &amp; kodi indeksimit</b>                                                                                                                                                                                                                         |             |        |      |                 |

|                         |             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |               |              |      |      |                 |
|-------------------------|-------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------|--------------|------|------|-----------------|
| E-2.1                   | Analize     | F.V Hidrant zjarri<br>AI - 5212                                                                                                                                                                                                                                                                                              | Kodi          | cope         | 2.00 | 0.10 | 0.20            |
| E-2.3                   | Analize     | F.V Fikëse zjarri me pluhur<br>AI - 5204                                                                                                                                                                                                                                                                                     | Kodi          | cope         | 4.00 | 0.10 | 0.40            |
| E-2.5                   | Analize     | F.V Buton sinjalizimi i zjarrit<br>- 5102                                                                                                                                                                                                                                                                                    | Kodi AI       | cope         | 4.00 | 0.10 | 0.40            |
| E-2.6                   | Analize     | F.V Lidhja me motopompen<br>AI - 5121                                                                                                                                                                                                                                                                                        | Kodi          | cope         | 2.00 | 0.10 | 0.20            |
| E-2.7                   | Analize     | F.V Zbritje shkalle<br>AI - 5103                                                                                                                                                                                                                                                                                             | Kodi          | cope         | 2.00 | 0.10 | 0.20            |
| E-2.8                   | Analize     | F.V Rrezik zjarri nga pajisjet elektrike nën<br>tension                                                                                                                                                                                                                                                                      |               | cope         | 2.00 | 0.10 | 0.20            |
| E-2.9                   | Analize     | F.V Ndalim i shuarjes së zjarrit me uje                                                                                                                                                                                                                                                                                      |               | cope         | 2.00 | 0.10 | 0.20            |
| E-2.10                  | Analize     | F.V Dalje emergjence                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |               | cope         | 2.00 | 0.10 | 0.20            |
| E-2.11                  | Analize     | F.V Drejtim i daljes së emergjences<br>- 5107                                                                                                                                                                                                                                                                                | Kodi AI       | cope         | 9.00 | 0.10 | 0.90            |
|                         |             | <b>Shuma E.1 (1+2)</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |               |              |      |      | <b>438.41</b>   |
|                         |             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |               |              |      |      |                 |
| <b>NR.</b>              | <b>KODI</b> | <b>EMËRTIMI I PUNIMEVE.</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | <b>NJËSIA</b> | <b>SASIA</b> |      |      | <b>VLEFTA</b>   |
|                         |             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |               |              |      |      |                 |
| <b>G.1</b>              |             | <b>SISTEMI I MBROJTJES KUNDER<br/>ZJARRIT</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                |               |              |      |      |                 |
| <b>G-1.1</b>            |             | <b>Hydrant Zjarri dhe grupi i motopompes</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                 |               |              |      |      |                 |
| G-1.1.1                 | Analize     | F.V Kaset + hidrant zjarri i brendshëm.<br>Kasetë brenda murit, llamarine çeliku e<br>emaluar me ngjyrë të kuqe RAL 3000 - UNI<br>9227, me baze rezine. Dimensionet<br>(370x610x190) mm, tub fleksibël 30 m,<br>Aksesorët: saraqineske ndërrprerëse 1½",<br>lançë + zorre uji DN 45. Pjesa e përparme e<br>mbyllur me çelës. |               | kompl        | 2.00 | 1.00 | 2.00            |
| G-1.1.2                 | Analize     | F.V Grupi i lidhjes me motopompen për<br>hidrant DN 65. Vendosja në kasetë të<br>jashtme, llamarine çeliku të emaluar në<br>ngjyrë të kuqe RAL 3000, valvol sigurie dhe<br>moskthimi 2" (DN 50) materiali i grupit bronz.                                                                                                    |               | kompl        | 2.00 | 1.00 | 2.00            |
|                         |             | <b>Shuma G.1 (1-3)</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |               |              |      |      | <b>4.00</b>     |
| <b>SHUMA TOTALE O/P</b> |             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |               |              |      |      | <b>9,188.67</b> |

|                                               |                |
|-----------------------------------------------|----------------|
| <b>ORE PUNE TOTAL<br/>PUNETORI + MAKINERI</b> | <b>9188,67</b> |
| <b>DITE PUNE</b>                              | <b>1148,58</b> |
| <b>MUAJ TOTAL Sp+p</b>                        | <b>44</b>      |
| <b>2 MUAJ</b>                                 | <b>22</b>      |
| <b>GJITHSEJ S+P</b>                           | <b>22</b>      |

**Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

**Argumentimi:** Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialistë i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje muajin e fundit, të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, tregon besueshmëri për autoritetin që operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruar me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. *Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendorsja e kriterit për një punësim të paktën 69(gjashtëdhjetë e nente) persona duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet.*

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 216 datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të cmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, Bazuar në katër elementet e strukturës së kostos (material, punëtori, makineri, transport).

Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore.

Këto përlogaritje si nevojë e transparencës ndaj ofertuesve po e paraqesim të detajuar, si më sipër.

### 2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës minimumi:

- Specialist për Punimet në lartësi D.P.I. 2 (dy)
- Bojaxhi 2 (dy)
- Pllakashtrues 4 (katër)
- Shtrues parketi 3 (tre)
- Specialiste betoni 2 (dy)

- Karpentier 1 (nje)
- Hekurkthyes 2 (dy)
- Mekanik 1 (nje)
- Teknik Ndertimi 1 (nje)
- Murator 1 (nje)
- Punetore 3 (tre)

te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë) nga organe kompetente si dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

-Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 1 (nje) manovrator dhe 2 (dy) shofere.

Per manovratorin deshmi e aftesise profesionale nga DPSHTRR, te cilat duhet te jene te vlefshme, dhe te figurojne ne listepagesa për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave ose kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund të disponohen së bashku me mjetet e marra me qera, pa pasur nevojë të jenë të përfshirë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues.

Per shoferin leje drejtimi e vlefshme dhe te figurojne ne listepagesa për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave ose kur mjetet disponohen me qera drejtuesit e mjeteve mund të disponohen së bashku me mjetet e mara me qera, pa pasur nevojë të jenë të përfshirë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues.

Për punëtorët e thjeshtë, duhet të disponojnë kontratë punë të vlefshme, si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave

**Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ose nëse do të jetë nevojë për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

**Argumentimi:** Në kriterin me sipër cituar është kërkuar që OE të kenë të punësuar teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, sipas fushave që përfshijnë punimet për zbatimin e projektit.

Këtu përfshihen kërkesat për punonjësit, të cilët janë trajnuar/certifikuar për kryerjen e punimeve të caktuara të zbatimit, pasi kanë kryer me sukses kurse dhe trajnime profesionale për punimet respektive. Zbatimi i punimeve që përfshin projekti duhet të kryhet nga fuqi punëtoare e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Punëtorët e ndërtimit dhe profesionet e lidhura me to ndërtojnë, mirëmbajnë dhe riparojnë ndërtesat dhe strukturat e tjera që nga themelet, muret dhe pjesët e tjera kryesore të ndërtesës dhe konstruksione të tjera, si jashtë ashtu edhe brenda duke përdorur teknika dhe materiale tradicionale apo moderne të ndërtimit. Ata kryejnë punime murature, suvatime, shtrim pllakash dhe parketesh, lysterje me bojë etj. Nisur nga punimet e parashikuara të zbatimit, në kriteret e veçanta janë kërkuar punëtorët e kualifikuar si vijon:

-Për zbatimin e punimeve ndërtimore të tilla si punimet e gërmimit, punimet strukturore, punimet e shtresave, rifiniturave, punimet e dymurave dhe dritareve, punimet hidraulike, punimet e tarracës, punimet e konstruksioneve metalike janë kërkuar 22 specialiste ndërtimi, të ndara si më poshtë:

-Për zbatimin e punimeve ku përfshihen projekti i rrjetit mekanik dhe te mbrojtjes nga zjarri dhe parashikohen punime të tilla si punime për instalimin e sistemit MKZ dhe instalimin e pajisjeve respektive. Të tilla punime do të realizohen në të gjithë vëllimet e objektit që do restaurohet dhe shtesa që do te ndërtohet. Kërkesa që OE të ketë të punësuar 1 (nje) specialist mekanik, është kërkesë shumë minimale, duke marrë parasysh vëllimin e punimeve.

-Punimet e muraturës në objekti parashikojnë ndërtimin e murit rrethues, për mbrojtjen e hapësirave të brendshme. Muratorët, realizojnë detyra të tilla si: Përzgjedhin materialet e nevojshme dhe veglat e punës para fillimit të procesit të punës, respektojnë me rigorozitet radhën e kryerjes së çdo procesi pune sipas orientimit të dhënë në objekt, bëjnë përgatitjen e sasisë së nevojshme të llacit për procesin ditor të punës, duke respektuar porcionet e duhura të materialeve përbërëse, bëjnë breza përforcues betoni në gjysmën e lartësisë së murit ose sipas specifikimit në projekt, kontrollojnë nëse muret janë të lidhur midis tyre horizontalisht dhe vertikalisht duke garantuar kështu qëndrueshmërinë e tyre, ndërtojnë soletat, vendosin arkitrarët e dyerve dhe dritareve, vendosin kondrakasat e dyerve dhe dritareve, nëse ka të tilla të parashikuara në projekt, bëjnë mbushjen me llac të mureve në nivelin e fashëve me dorë ose me pompë në varësi të materialit të përcaktuar nga drejtuesi teknik në objekt, përgatitin materialin e nevojshëm për tavane me gips apo për tavane të varura zbukurues duke bërë matjet dhe prerjet e duhura, bëjnë stukime apo riparimet e duhura të objekteve të ndryshme, bëjnë kontrollin përfundimtar të punimeve, duke u siguruar që gjithçka është sipas përshkrimit në projekt etj.

-Për punimet e bojatisjeve të brendshme dhe të jashtme të të gjithë mureve dhe tavanëve AK ka kërkuar që OE të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) bojaxhinj. Bojaxhiu dhe të tjerë që lidhen me to merret me përgatitjen e sipërfaqeve të ndërtesave dhe strukturave të tjera për lyerje, përgatitjen e materialeve që do të përdoren për lyerje, lyerjen dhe dekorimin e sipërfaqeve të ndryshme sipas projekteve dhe kërkesave të klientëve. Ai mund të vendosë shtresa të materialeve mbrojtëse dhe dekorative të ngjashme ose të mbulojë mure të brendshme dhe tavane të ndërtesave me tapiceri dhe materialeve të ndryshme si: letër, mëndafsh, stof e të tjera. Ky numër është shumë minimal në raport me vëllimin e punës, për realizimin e të tilla punimeve në të gjithë vëllimet e objektit.

-Shtruesi i pllakave (pllaka shtruesi) dhe të tjerë që lidhen me to instalon, mirëmban dhe riparon parkete dhe lloje të tjera të dysHEMEVE ose mbulojnë dysHEMETË, muret ose sipërfaqet e tjera me pllaka ose panele mozaikësh për qëllime dekorimi ose të tjera. Punimet e parashikuara në këtë projekt parashikojnë shtrimin e të gjitha dysHEMEVE të kateve, shtrimin e sipërfaqeve të shkelhme të shkallëve, shtrimin me pllaka të mureve të tualeteve etj. Këto punime në preventiv përfshijnë sipërfaqe të mëdha.

Pra për realizimin e kyre zerave AK ka kërkuar që OE të ketë të punësuar një numër minimal prej 4 (kater) pllakashtruesish dhe 3 (tre) shtrues parket/laminati. Ky numër është shumë minimal në raport me vëllimin e punës, për realizimin e të tilla punimeve në të gjithë vëllimet e objektit, në të cilët do të punohet paralelisht.

- Punimet e betonit dhe b/a të parashikuara në projektin konstruktiv, specifikimet teknike, prevetivin dhe grafikun e punimeve lidhen ngushtë me proceset e derdhjes së betonit, pjesë e të cilave është edhe përgatitja e kallëpëve. Krahas punimeve të betonit dhe betonarmesë parashikohet edhe ndërtimi i skelave, të cilat krahas strukturave metalike parashikojnë edhe shumë punime druri. Për realizimin e punimeve të tilla është e nevojshme që OE të zotërojë minimalisht 1 (nje) karpentier.

-Për zbatimin e punimeve të konstruksioneve metalikë, montimin e hekurit të betonit që do të hidhet në murin rrethues nga Ak është kërkuar që të punësuar një numër minimal prej 2 (dy) hekurkthyes. Punime të tilla duhet të realizohen me saktësi nga punëtorë të kualifikuar. Projekti i parashikuar të zbatohet nëpërmjet kësaj procedure parashikon realizime të strukturave metalike, siç janë stolat dekorative, porta metalike për territorin e jashtëm, konstruksione metalike si dhe kthimin e hekurit të domosdoshëm për strukturat b/a janë kërkuar minimalisht 2 (dy) hekurkthyes.

- Duke iu referuar preventivit te pasqyruar ne DST parashikohen ngritje skelash dhe punime ne lartesi. Kjo kërkesë e AK lidhet me faktin se projekti i parashikuar të zbatohet nëpërmjet kësaj procedure parashikon punime fasade, catie si dhe vendosja e ullukeve horizontale dhe vertikale. Per kete arsye jane kerkuar 2 (dy) punonjes per punime ne lartesi.
- Jane kerkuar 2 (dy) specialiste betoni per hedhjen dhe ngjeshjen e betonit tek muri rrethues.
- Tekniku i ndertimit duhet te jete prezente ne kantier cdo dite te punes per te mbikqyrur dhe dhene orientime gjithë stafit te punonjesve per zbatimin e projekt-preventivit.
- Jane kerkuar 3 (tre) punetore te thjeshte te cilet jane ndihmes te specialisteve te mesiperm duke sjelle materialet ne kantier si dhe per pergatitjen e llacit dhe te betonit.

Percaktimi i numrit te punonjesve dhe profesionet eshte bazuar mbi zerat dhe volumet e punes si dhe afateve per perfundimin e punimeve, ne mbeshtetje te Manualit te ndertimit miratuar me Vendim Nr. 216, datë 13.4.2023. *Bazuar ne kater elementet e struktures se kostos(material, puntori, makineri, transport).* Numri i punonjesve dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Per kete duhet te paraqitet certifikata e trajnimit per “Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit per pune”, ose ekuivalente, e dhene nga nje organizem i licensuar, shqiptar ose i huaj si dhe kontrata e punes.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- Kontratë Pune të vlefshme

**Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" Neni 7 .... Sherbimet e mbrojtjes dhe te parandalimit ... 1. Punedhenesi ngarkon nje ose disa punemarres, qe te merren me ceshtjet e mbrojtjes, te sigurse e shendetit ne pune dhe te parandalimit te rreziqeve

profesionale ne ndermarrje /institucion ....., dhe V.K.M nr.312, date 05.05.2010 "Per miratimin e rregullores per sigurine ne kantier ". Autoriteti Kontraktor ka qellim realizimin e kontrates objekt prokurimi sipas kushteve te percaktuara ne DST, duke respektuar cdo rregull lidhur me kantierin e ndertimit si dhe me sigurine e punonjesve gjate ushtrimit te veprimtarise se punes. Eshte e rendesishme qe punimet te realizohen brenda nje kantieri te sigurt duke mbrojtur jeten e punonjesve, por dhe te kalimtareve qe mund te jene perreth vendit te punimeve. Per sa me lart, punonjesi i cili eshte i certifikuar si "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune", nepermjet dijes dhe eksperiences te fituar ne kete fushe, duhet te shmange apo parandaloje cdo rrezik qe mund te shfaqet gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe mund te cenoje shendetin apo sigurine ne pune. Ne keto kushte, vendosja e ketij kriteri sherben si nje garanci qe ofertuesit do te reazlizojne punimet sipas standarteve ligjore ne fuqi.

Bazuar dhe ne V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënëz zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

**Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

**2.3.8** Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në pajisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

|                                  |        |                        |
|----------------------------------|--------|------------------------|
| Autoveteshkarkuese 5 deri 10 ton | copë 2 | Ne pronesi ose me qera |
| Kamioncine deri ne 3.5 ton       | copë 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Eskavator 0.25 m3                | copë 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Autovinç                         | copë 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Gjenerator                       | cope 1 | Ne pronësi ose me qira |
| Vibrator thellesie               | cope 1 | Ne pronësi ose me qira |
| Zmerilatrice                     | copë 1 | Ne pronesi ose me qera |
| Trapano Elektrike                | copë 1 | Ne pronesi ose me qera |

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton regjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), certifikatën e kontrollit teknik (*të vlefshme*), siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), kurse për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet me kontrata përkatëse e qerasë/furnizimit dhe dokumentacionin që vërteton regjistrimin e tij (*leje qarkullimi*), certifikatën e kontrollit teknik (*të vlefshme*), siguracionin e mjetit (*të vlefshme*).
- Në rastin e mjeteve të tjera duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre si aktet e zhdoganimit/faturat tatimore të blerjes dhe kur ato janë të marra me qera të paraqitet kontrata

e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj si edhe dokumentat që vërtetojnë pronësinë e qiradhënësit si aktet e zhdoganimit/ faturat tatimore të blerjes.

- c) Mjetet, pajisjet teknike dhe mjetet mbrojtëse të mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera gjatë afatit kohor të zbatimit të kontratës objekt të këtij prokurimi. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë brenda orarit të punës, në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës, mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr.8.

**Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi / qira / kontrate furnizimki janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Gjithashtu për përcaktimin e numrit të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018).

**2.3.9** Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

- ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) -ose ekuivalent.
- ISO 14001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor) -ose ekuivalent
- ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë) - ose ekuivalent.

*Te gjitha Certifikatat duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH”.*

*Në rast Bashkimi të Operatorëve Ekonomikë, secili Operator Ekonomik duhet të dorëzojë çertifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marre përsiper të realizojë, referuar kontrates së bashkepunimit të nënshkruar.*

**Argumentim:** *Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas kësaj pike janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret

realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001:2018 e përditësuar, (SSH EN UNI ISO 45001 – 2023) është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

## **Argumentimi i specifikimeve teknike**

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike, termat e references, raporti teknik, preventivi me zerrat e punimeve janë pjese DST.

Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet/Relacioni Teknik/preventivi/projekti dhe grafiku per proceduren respektive jane hartuar nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit te territorit prane Bashkise Pogradec. Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

Fondi Limit i perlllogaritur per kete procedure eshte hartuar ne baze te VKM nr 216 date 13.04.2023.

Vendosja dhe argumentimi i kriterëve /Hartimi i kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitetet teknike për këtë objekt prokurimi është bërë nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimi, në respektim dhe të parashikimeve të nenit 74/4 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

NJËSIA E PROKURIMIT